

Kastriot VESELAJ

**KËRKESAT E INTELEKTUALËVE SHQIPTARË DËRGUAR
LIDHJES SË KOMBEVE PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE
QYTETARE DHE KOMBËTARE TË SHQIPTARËVE NË
MBRETËRINË SKS-JUGOSLLAVE (1924-1931)**

Abstrakt:

Punimi tenton të sjellë në pah përpjekjet e vazhdueshme të intelektualëve shqiptarë për sigurimin e të drejtave elementare në radhë të parë. Përpjekjet nuk përfshinin vetëm të drejtat bazë, por edhe të drejtat politike dhe demokratike të shqiptarëve, brenda kuadrit juridik vendor dhe ndërkombëtar. Këto të drejta përfshinin të drejtën për shkollim, themelimin e institucioneve kulturore, shtypin e lirë dhe përdorimin e lirë të gjuhës amtare. Po ashtu, përpjekjet synonin ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në përgjithësi dhe në veçanti të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Sllovene (pas vitit 1929, në Mbretërinë Jugosllave). Në këtë aspekt një rëndësi të veçantë kishte argumentimi dhe informimi i faktorit publik të kohës për gjendjen e krijuar me rastin e ripushtimit të tokave shqiptare nga forcat serbo-malazeze në fund të Luftës së Parë Botërore e për të vazhduar, pothuajse, përgjatë gjithë periudhës në mes dy luftërave botërore. Ishin intelektualë shqiptarë, si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Kadri Prishtina, Bedri Pejani, Ibrahim Jakova, Dom Gjon Bisku, Dom Shtjefën Kurti, Dom Luigj Gashi etj., që në vazhdimësi, më anë të letrave, të peticioneve, të memorandumeve, të kontakteve të drejtpërdrejta, pastaj të artikujve të botuar në medime të ndryshme dhe jo vetëm, informuan qeveritë, politikanët, individët e dalluar, shoqëritë ndërkombëtare (qeveritare dhe joqeveritare), vetë Konferencën e Paqes, Lidhjen e Kombeve dhe mekanizmat e saj për pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë SKS-Jugosllave. Shumica e burimeve në këtë punim janë nga "United Nations Library & Archives Geneva", me fondin: Société des Nations, e që janë një burim mjaft i rëndësishëm i hulumtimeve shkencore për këtë periudhë dhe për shqiptarët në Mbretërinë Jugosllave.

Fjalë kyçe: *Intelektualët shqiptarë, Lidhja e Kombeve, Mbretëria SKS-Jugosllave, petitionet/memorandumet.*

Intelektualët shqiptarë të kohës së pas Luftës së Parë Botërore, ishin ndër personalitetet të ndritur me ide, vizion, guxim e veprimtari atdhetare, duke dhënë një kontribut të çmueshëm jo vetëm për çlirimin dhe bashkimin kombëtar, por edhe për ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare në përgjithësi e në veçanti të shqiptarëve jashtë Shqipërisë së vitit 1913-të. Ky angazhim kishte filluar që në organizimet ndërkombëtare të pasluftës siç ishte Konferenca e Paqes së Parisit, Lidhja e Kombeve e mekanizmat e saj etj., por nuk mungonin edhe në raport e takime me qeveritë e institucionet tjera botërore e evropiane si dhe informimet mediatike ndërkombëtare e kombëtare, nëpër gazetata e kohës dhe jo vetëm.

Intelektualët shqiptarë dhe Lidhja e Kombeve

Ndonëse rrethanat politike ndërkombëtare dhe kombëtare në vitet e ‘20-ta dhe ‘30-ta të shekullit XX - të kishin ndryshuar, ato nuk i penguan intelektualët shqiptarë të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene (e pas vitit 1929 Jugosllave), që veprimtarinë e tyre patriotike e kombëtare ta shtronin edhe më shumë në rrafshin diplomatik. Ata vetës së tyre tanimë ia kishin shtuar edhe një çështje shumë të rëndësishme siç ishte çështja e popullsisë shqiptare në këtë mbretëri dhe ndërkombëtarizimin e kësaj çështjeje në mekanizmat diplomatike evropiane e botërore. Ata gjithashtu, vizituan shumë qendra administrative evropiane, binin në kontakte të vazhdueshëm me disa qendra diplomatike si evropiane, por edhe me ato shqiptare që vepronin në emigrim dhe çdoherë përpiqeshin të kërkonin më të mirën për popullin shqiptar që jetonin në Mbretërinë SKS-Jugosllave, duke theksuar se “... një milion shqiptarë në Jugosllavi po keqtrajtoheshin pothuajse në çdo drejtim. Ata po grabiteshin. Shumë nga shqiptarët ishin të vararë. Atyre po u krijoheshin vështirësi të shumta në çdo sferë të jetës, me qëllim që të braktisnin tokën e tyre”.¹ Gjithashtu nga ata tregohet, se si populli shqiptar po detyrohej

¹ Agjencia Shtetërore e Arkivit të Kosovës - Prishtinë (më tej: *ASHAK*), Fondi (më tej: *F.*): Ministria e Punëve të Jashtme, Njësia Organ (më tej: *NO*): Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti 1927-1937, Letra e Hasan Prishtinës në emrin e Komitetit Shqiptaro-Maqedonas për

nëpërmjet metodave të një tendence gjakatare të largohen nga vatrat e të parëve të tyre. Ata i kërkonin qeverive të ndryshme siç ishte ajo britanike që “të mbronte jetën dhe ekzistencën e kërcënuar të një milion shqiptarëve në Jugosllavi nga tirania serbe”.²

Por, angazhimi më serioz dhe më diplomatik ishte në raport me Lidhjen e Kombeve dhe asociacionet e saj, me dërgimin e shumë kërkesave, peticioneve e memorandumeve duke kërkuar sigurimin e lirive kombëtare të shqiptarëve jashtë Shqipërisë, në një kohë kur kundërshtarët ishin aktivizuar me të madhe për kundërshtimin e këtyre argumenteve. Argumente këto të mbështetura me të dhëna të siguruara, madje edhe të publikuara në mjetet e informimit jugosllav e botëror në gjuhët e ndryshme, por edhe në dokumente zyrtare diplomatike, e në burimet të proveniencës parlamentare jugosllave, evropiane por edhe shqiptare, në kërkesat dhe peticione të përfaqësuesve politikë legalë të popullit shqiptar në Jugosllavi, siç ishin: “Xhemijeti” me Nexhib Dragën, Nazim Gafurrin, Sheh Mehmet Sezain, Ferat Dragën, Ahmet Shtimjen, e nga përfaqësuesit ilegalë të Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, si: Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Kadri Prishtina, Ibrahim Jakova etj., por edhe nga deputetët tjerë shqiptarë në Parlamentin jugosllav, si: Ramë Bllaca, Sherif Voca, Aqif Bluta e shumë të tjerë.³

Më 26 shtator 1924, tre intelektualët e kohës, Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Bedri Pejani, si përfaqësues të “Komiteteve të Bashkuara të Irredentistëve Shqiptarë”, ia paraqesin një “memorandum ankese”, kreut të Këshillit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, ku protestojnë me argumente dhe me fakte për dhunën serbe kundër shqiptarëve.⁴ Mes tjera aty thuhet se:

Maqedoni dhe Kosovë, dërguar Lordit Curzon, shkurt 1926.

² Pranvera Teli (Dibra), *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927 (nën dritën e burimeve arkivore angleze)*, Shtëpia Botuese: “NERAIDA”, Tiranë 2005, 34.

³ Shih më gjerësisht: Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë në vitin 1918-1941*, Prishtinë 1981.

⁴ United Nations Library & Archives Geneva, (më tej: *UNLAG*), Fondi (më tej F.): Société des Nations (më tej SdN), Les minorités albanaises en Yougoslavie [Royaume des Serbes, Croates, et Slovènes] - Représentants des Comités unis des Albanais irrédimés - Soumettent au Président du Conseil de la Société des Nations un mémorandum au sujet des Albanais de Cossovo [Kosovo], de la Macédoine et du Monténégro - Council document C.764.1924.I, (Registry: Classement no: 41, Document no: 39302, Dossier no: 11379), Date (s): 1924.09.26 (Création/Production), Reference Code: R1657/41/39302/11379.

*“Komitetet tona i janë drejtuar Konferencës së Paqes, asaj të Ambasadorëve, Lidhjes së Kombeve dhe opinionit publik të botës së civilizuar që në ditët e para të rivendosjes së sundimit serb në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi (15-30 tetor 1918) për të protestuar kundër regjimit dhe faktit se shteti Serbo-Kroat-Slloven nuk i respekton të drejtat e pakicave, porse edhe u mohon shqiptarëve të drejtat në jetë”.*⁵

Këto veprime dhe jo vetëm, ishin gjithashtu edhe në kundërshtim të plot me Traktatin e Sen-Zhermenit⁶ dhe vendimet e saja të 10 shtatorit 1919, ndërmjet Fuqive Aleate dhe Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene.⁷ Mirëpo, Këshilli i Lidhjes së Kombeve, fatkeqësisht nuk mori asnjë masë në sesionin e dhjetorit të vitit 1924, por vetëm njoftoi anëtarët e saj rreth memorandumit të adresuar në Këshillin e tyre nga “Komitetet e Bashkuara të Irredentistëve Shqiptarë”, të përfaqësuar nga Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Bedri Pejani. Këshilli e njoftoi edhe qeverinë mbretërore-jugosllave dhe nga kjo e fundit mori reagime të ashpra kundërthënëse,⁸ duke i dërguar disa ankesa të njëpasnjëshëm e duke tentuar t’i shtrembërojnë të vërtetat reale rreth vendbanimeve shqiptare në Mbretërinë SKS-Jugosllave dhe se siç thuhet në këto reagime, “... qeveria mbretërore nuk e sheh të arsyeshëm t’u përgjigjet akuzave të një turpi, siç është “Bashkimi i Komiteteve të Irredentistëve Shqiptarë” dhe se “... këto komitete nuk janë as të kualifikuar e as nuk e kanë

⁵ Po aty, 1; Në këtë memorandum është edhe shtojca që shënoheshin e shtjelloheshin me fakte shtatë pika e që dëshmonin politikën e Beogradit ndaj shqiptarëve, si në vijim: 1. Organizimi i bandave të armatosura nën emrin e organizatave kombëtare; 2. Organizim masakrash periodike me pretextin e shtypjes së kaçakëve (dezertorëve); 3. Kolonizimi i fshatrave të shkatërruara dhe shtëpive të braktisura; 4. Plaçkitja e legalizuar; 5. Emigrimi masiv i shqiptarëve; 6. Liria kushtetuese; 7. Drejtësia serbe.

⁶ Shih më gjerësisht: Margaret MacMillan, *PARIS 1919 SIX MONTHS THAT CHANGED THE WORLD*, Random House Trade, 2003.

⁷ Marenglen Verli, *Nga Kosova për Kosovën*, vëll. I, Tiranë 2006, 244.

⁸ Këto dokumente të rëndësisë së veçantë gjenden në: United Nations Library & Archives Geneva, Fondi: Sociéte des Nations. Fjala është për përgjigjen e Qeverisë jugosllave rreth ankesave të minoriteteve dërguar Lidhjes së Kombeve e të dorëzuara në formë memorandumimi nga të ashtuquajturit “Komitetet e Bashkuara të Irredentistëve Shqiptarë”, të 26 shtator 1924, më 29 nëntor 1924, me tri dokumente në shtojcë: shtojca nr. 1 për vdekjen e rebelëve shqiptarë nga Kosova, Azem Bejta, gjithashtu i njohur si Azem Galiza, më 25 korrik 1924; shtojca nr. 2 për këmbim zjarri me bandat e Mehmed Konjuhut dhe vëllezërit Bajçinovci; dhe shtojca nr. 3 për dyndjen e shqiptarëve.

autorizimin të flasin në emër të minoriteteve shqiptare në Mbretëri”””⁹

Angazhimet diplomatike të intelektualëve shqiptarë, sidomos të Hasan Prishtinës¹⁰ dhe përpjekja e tij në të mirë të zgjidhjes së çështjes së shqiptarëve në Mbretërinë SKS-Jugosllave e imponuar nga gjendja e jashtëzakonshme në të cilën gjendeshin shqiptarët, e ku theksi i tyre bie në kërkesën për ndalimin e masave me tendencë eliminuese-gjenocidale ndaj popullit shqiptar që zbatoheshin nga regjimi i Beogradit,¹¹ do të shënohet me paraqitjen e një proteste të re në Lidhjen e Kombeve, e cila mbanë datën 15 mars 1927, e ku i drejtoi një protestë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Eric Drummond, për gjendjen në Kosovë dhe Maqedoni, ku i vinte në pah se “... gjendja e dëshpëruar e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi më shtrëngon t’i drejtohem sërish Lidhjes së Kombeve me lutjen që të merren masa të tjera për të ndihmuar një popull të shtypur e të torturuar”.¹²

Në këtë protestë të formuluar shkurtimisht në emër të popullit shqiptar, Hasan Prishtina i përmbledh në tri pika kërkesat e tij drejtuar Lidhjes së Kombeve. Aty bëri të ditura me fakte që vërtetonin gjendjen e dëshpëruar të shqiptarëve në Mbretërinë SKS dhe se afro 1 milion shqiptarë që jetonin në këtë mbretëri, nuk kanë as edhe një shkollë të vetëm në gjuhën e tyre (shqipe) dhe jo vetëm që u ndalua arsimit kombëtar, por qeveria po përdorë, të gjitha mënyrat e mundshme që t’i shfaros, duke i vrrarë e plaçkitur, e duke i tatimuar rënd dhe duke ia konfiskuar edhe pasurinë pa kompensim, për t’ua dhënë kolonëve serbë dhe atyre malazezë, si dhe duke i detyruar shqiptarët për ta braktisur në masë vendin e të parëve të tyre.¹³

⁹ Po aty, fl.16.

¹⁰ Për rolin e Hasan Prishtinës në raport me Lidhjen e Kombeve shih për më shumë: Kastriot I. Veselaj dhe Sabit Muçaj, “Hasan Prishtina dhe Lidhja e Kombeve (1924-1931)”, në: “Ballkan Journal of Interdisciplinary Research”, (Tiranë: Vol.1, No.1, May 2015), IIPCCCL Publishing, Acces this Journal online at www.iipcccl.org, Tiranë Albania 2015.

¹¹ Emine Arifi-Bakalli, “Përpjekjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për realizimin e të drejtave demokratike e kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi”, Revista: KOSOVA nr. 22-23, Instituti i Historisë, Prishtinë 2003, 160.

¹² ASHAK, F.: Ministria e Punëve të Jashtme, NO: Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti 1927-1937, Protestë e Hasan Prishtinës, Vejnë, data 15 mars 1927, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve sër Erik Drummond, fl.1.

¹³ Sipas historianit Robert C. Austin “Qëllimi minimal ishte të siguronin të drejtat e

Hasan Prishtina, në fund të këtij peticionit i kërkonte Lidhjes së Kombeve, që ajo “të caktojë një komision të paanshëm me detyrë që të shkojë në Jugosllavi dhe të shqyrtojë në vend gjendjen e pakicës shqiptare atje”.¹⁴ Mirëpo, Eric Drummond, më 15 prill 1927 e informoi Hasan Prishtinën se memorandumit i tij, nuk mund të merrej në shqyrtim, nga shkaku se pohimet ishin me karakter shumë të përgjithshëm. Këto përgjigje, nuk i pëlqyen përfaqësuesve jugosllavë në Lidhjen e Kombeve, duke bërë që ata të reagojnë te drejtori i Sektorit për Minoritete, Kolbani, dhe duke marrë garanci nga ky i fundit se reagimi i Sekretarit të Përgjithshëm ishte “një formalitet i zakonshëm dhe plotësisht pa kurrfarë vlere”.¹⁵

Sidoqoftë, në këto rrethana të krijuara dhe duke parë përgjigjen “ironike” të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, vetë Hasan Prishtina vendosi që të dërgonte dhe një peticion të ri, më të detajuar e të plotësuar me të dhëna të plota e argumente të rëndësishme, si plotësim të peticionit të 15 marsit, si dhe duke marrë kontakte të shumta me intelektualët e kohës, ndër të tjera edhe me nënsekretarin e Lidhjes së Kombeve, Grandi, dhe me shumë burra shtetesh e delegatë të shteteve të ndryshme në Lidhjen e Kombeve.¹⁶

I gjithë aktiviteti diplomatik i Hasan Prishtinës në Gjenevë ishte ndjekur me kujdes të madh nga diplomacia jugosllave, e cila bëri edhe përpjekje edhe ia arriti ta sabotonin diskutimin e memorandumit të vitit 1927 në Lidhjen e Kombeve. Por, këmbëngulësia e Hasan Prishtinës do ta detyronte Këshillin e Lidhjes së Kombeve ta merrte në shqyrtim

minoriteteve për pakicat...”, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit: Demokracia Shqiptare në vitet 1920-1924*, (Tiranë: publisher “Albin” 2000), 3.

¹⁴ ASHAK, F.: Ministria e Punëve të Jashtme, NO: Shoqata e Kombeve në Gjenevë, viti 1927-1937, Protestë e Hasan Prishtinës, Vejnë, data 15 mars 1927, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Eric Drummond, fl.2.

¹⁵ Marenglen Verli, “Rreth veprimtarisë diplomatike të Hasan Prishtinës për çështjen shqiptare, nga Parlamenti osman deri në Lidhjen e Kombeve”, në: Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës (Konferencë shkencore, 13-14 tetor 2012), vëllimi 4, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore, Shkup 2012, 360.

¹⁶ Muhamet Pirraku, *Hasan Prishtina, Vlerë sublime e Kombit*, “Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Prishtinë 2013, 276. Sipas dokumentacionit jugosllav të kohës, të cituar në këtë vepër, Hasan Prishtina me përkrahjen e Iljaz bej Vrionit dhe Xhemail Dinos, delegatëve të Shqipërisë, arriti të merrte pjesë në mbledhjet e Lidhjes së Kombeve.

memorandumin e datës 15 mars 1927, i cili ishte plotësuar dhe ishte detajuar në gusht të vitit 1927. Megjithatë për vënien e tij në programin e punës së Lidhjes së Kombeve do të bëhej një “luftë diplomatike” dhe vetëm në prill të vitit 1929 (po thuajse dy vjet pas petitionit të 15 marsit), ngaqë Hasan Prishtina i tërhoqi sërish vëmendje Lidhjes së Kombeve, do të futej në programin e punës së Lidhjes së Kombeve.

Në petitionin e datës 5 prill 1929, Hasan Prishtina reagoi përsëri dhe këtë herë në mënyrë mjaft të detajuar, për gjendjen dhe mohimin e të drejtave që u takojnë pakicave kombëtare sipas konventave ndërkombëtare dhe në vijë me parimet e njerëzimit bashkëkohor. Me shumë gjasë, ky petition duke e krahasuar me petitionin e vitit 1927, ishte i shkruar me një ton pak më të matur dhe më diplomatik në raport me Lidhjen e Kombeve dhe mekanizmave të saj.¹⁷ Aty gjithashtu ishin dhënë disa detaje për dhunën, terrorin, vrasjet administratat tatimore, lirinë e shtypit, pasojat e terrorit të ushtruar gjatë zgjedhjeve dhe jo vetëm, por gjithashtu, ishte edhe më i matur dhe pa fyerje edhe aq të rënda ndaj Mbretërisë Jugosllave,¹⁸ dhe duke menduar së në përgjigjen e protestës së mëparshme të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, sër Eric Drummond, ju kishte bërë të ditur se “... *natyra e përgjithshme e pohimeve të mia në letër nuk ia mundësonte Lidhjes së Kombeve të përcaktonte po qe se procedura e paracaktuar nga Këshilli për një ankesë pakicash mund të zbatohej*”.¹⁹ Ndonëse u bën përpjekje të jashtëzakonshme për kundërshtimin edhe të këtij peticioni nga qeveria

¹⁷ Toni më i matur i Hasan Prishtinës në dy petitionet/memorandumet e fundit, të gushtit 1927 (të paraqitur me 5 prill 1929) dhe 15 mars 1930, lidhej me situatën e re ndërkombëtare të krijuar pas miratimit të Traktatit të Parisit të 27 gushtit 1928, nënshkruar nga shtetet anëtare të Lidhjes së Kombeve. Ku sipas këtij Traktati, lufta si mjet për të fituar lirinë dënohej dhe kufijtë shtetërorë mund të rishqyrtohen e të ndryshonin vetëm me bisedime bilaterale të palëve në konflikt, prandaj Hasan Prishtina pas kësaj u orientua për të siguruar për çështjen e Kosovës zgjidhjen politike në kuadër të veprimtarisë së Lidhjes së Kombeve.

¹⁸ UNLAG, F: SdN, PETITION DE HASSAN BEY PRISHTINA CONCERNANT LA SITUATION DE LA MINORITE ALBANAISE DAN LE DIT ROYAYNE, PROTECTION DES MINORITES DANS LE ROYAUME DES SERBES, CROATES ET SLOVENES, Note du Secetaire general, (Document C. 334, 1909, I), (Voir également C. 370. 1929. I), Date(s): 1929-1930 (Creation), Protection period to: 1970-12-31 Registry no: 4/13737/10528, Reference Code: R2166-4-10528-13737.

¹⁹ Po aty, fl. 248.

jugosllave, ajo madje iu përgjigj Këshillit të Lidhjes së Kombeve se ky peticion ishte i papranueshëm duke i justifikuar se Hasan Prishtina “... *kishte qenë një revolucionar dhe irredentist i angazhuar në aktivitete subversive kundër Jugosllavisë*”.²⁰

Gjithashtu qeveria jugosllave i paraqiti një memorandum Këshillit të Lidhjes së Kombeve më datën 21 gusht 1929, në të cilin kundërshtoheshin akuzat e Hasan Prishtinës për shtypjen e minoritetit shqiptar në Jugosllavi dhe deklarohet se në Jugosllavi “... *ekzistonte një numër i madh shkollash me klasa të veçanta për fëmijët shqiptarë*”.²¹ Mirëpo, në shtator 1929 Komiteti i të Treve e shqyrtoi peticionin e Hasan Prishtinës, madje Lidhja e Kombeve ngriti një komision të përbërë nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, Persisë dhe të Finlandës. Mirëpo, nga raporti i këtij komisionit që mban datën 29 dhjetor 1929, nuk kishte ndonjë rezultat konkret dhe reagues dhe shihet se Lidhja e Kombeve si duket ishte nën kontrollin e Fuqive të Mëdha dhe ndiqte vijën e interesave të tyre politike duke mos i përfillur interesat e popujve të vegjël.²²

Hasan Prishtina me bashkëpunëtorë si duket nuk u pajtua me një përgjigje kaq denigruese, madje me tendencë ofenduese kundër ekzistencës kombëtare të popullsisë shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Dhe si ish-kryeministër shqiptar, mbase edhe si përfaqësues i shqiptarëve që jetonin në territorin e Mbretërisë Jugosllave, më datë 15 mars 1930 iu drejtua kryetarit të Komitetit Tresh të Lidhjes së Kombeve për studimin e çështjes së pakicave kombëtare, se “... *qeveria mbretërore jugosllave ka deklaruar se ankesat tona kishin mbështetje për shkak se shqiptarët në Jugosllavi i gëzojnë liritë e plota, kanë shkolla dhe i ushtrojnë të drejtat politike. Këto deklarata*

²⁰ UNLAG, F: SdN, Minorités albanaises dans le Royaume des Serbes, Croates et Slovènes - Mémoire communiqué par M. Choumenkovitch, 21 août 1929, Date(s):1929, Note: Protection period to: 1969-12-31, Registry No: 4/13975/10528, Reference Code: R2166/4/13975/10528. Fjala është për Letrën e Qeverisë serbe, kroate dhe sllovene, (J. Sumenkoviç, delegacioni i përhershëm i Mbretërisë së Serbëve, të Kroatëve dhe Sllovenëve në Lidhjen e Kombeve) dërguar Lidhjes së Kombeve, Gjenevë, 11 korrik 1929.

²¹ Po aty, Memorandumi i delegatit të përhershëm të Jugosllavisë dërguar Lidhjes së Kombeve për trajtimin e popullatës shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë, më 21 gusht 1929.

²² Muhamet Pirraku, *Hasan Prishtina...*, 308.

nuk përputhen me të vërtetën në asnjë mënyrë".²³ Mirëpo e vërteta ishte ndryshe, se në Jugosllavi nuk kishte asnjë shkollë shqiptare dhe se shqiptarët shtypshin madje edhe janë zhveshur bile edhe nga pronat e tyre dhe ato i janë shpërndarë serbëve, malazezëve, rusëve e të tjerëve. Hasan Prishtina duke firmosur si ish-kryeministër, këmbëngulte në vërtetësinë e memorandumeve të dërguar më parë dhe nga ky Komitet, kërkonte "... një komision hetimor neutral dhe i paanshëm" ²⁴ të dërgohej për të konstatuar gjendjen e vërtetë të shqiptarëve dhe të bindet për të vërtetën.

Në këto rrethana të krijuara, është i njohur edhe peticioni i tre klerikëve katolikë shqiptarë të arrestuar nga Jugosllavia pas vrasjes së At Shtjefën Gjeçovit, Dom Gjon Bisaku nga Prizreni (deri vonë prift në famullinë e Becit, qarku i Gjakovës), Dom Shtjefën Kurti nga Prizreni (deri vonë prift në famullinë e Novosellës) dhe Dom Luigj Gashi nga Shkupi (deri vonë prift në famullinë e Smaçit, Becit, qarku i Gjakovës), shtetas jugosllav, misionarë të "Propaganda Fides". Ky peticion, u dorëzua më 5 maj 1930 në Gjenevë, Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Eric Drummond,²⁵ i cili ishte pothuajse në frymën e peticioneve/memorandumeve të Hasan Prishtinës, mbase edhe i projektuar nga vetë ai. Ky dokument i përgatitur me shumë argumente e fakte, prej rreth 30 faqesh,²⁶ i paraqitur nga personalitete shqiptare të klerit të krishterë, që mbështeste kërkesat dhe ankesat e përsëritura të Hasan Prishtinës, diskreditonte përgjigjet zyrtare të

²³ Robert Elise & Bejtullah Destani, redaktorë, *Kosova, një histori dokumentare, nga lufta ballkanike deri në Luftën e Dytë Botërore*, Koha, Prishtinë, maj 2019, "Letër nga Hasan Prishtina në Vjenë dërguar kryetarit të Komitetit të Treshes së Lidhje së Kombeve për Sundimin e Pakicave Kombëtare në Gjenevë, më 15 mars 1930, në përgjigje memorandumit jugosllav për të drejtat e pakicës shqiptare në Jugosllavi (përkthyer nga frëngjishtja)", 393.

²⁴ Po aty, 394.

²⁵ Për më gjerësisht shih: UNLAG, F: SdN (Minorities), Council Documents, 1933, C.41-C.159, (Confidential), "PROTECTION DES MINORITES EN YOUGOSLAVIE. PETITION DE DON JEAN BISAKU, DON ETIENNE KURTI ET DON LOUIS CONCERNANT LA SITUATION DE LA MINORITE ALBANAISE DANS LE ROYAUME DE YOGOSLAVIE", Registry No: 4/612-612, Date(s): 1933-02-16 (Creation), (Doc. C. 647.1930.I.), Reference Code C-129-1933-I_FR.

²⁶ Po aty. Peticioni gjithashtu ka edhe pjesën e shtojcave, si në vijim: Shtojca 1 - Mbrojtja e jetës; Shtojca 2 – Mbrojtja e lirisë; Shtojca 3 – E drejta në pronë; Shtojca 4 – Të drejtat civile dhe politike; Shtojca 5 – Përdorimi i gjuhës kombëtare; Shtojca 6 – Shkollat dhe bamirësitë private; Shtojca 7 - Arsimi publik; Shtojca 8 – Fondacionet private fetare.

Beogradit drejtuar Lidhjes së Kombeve. Ku ndër të tjera, në peticion, thuhej se *“ne të nënshkruarit, që të tre misionarë të “Propaganda Fide” dhe shtetas jugosllavë me kombësi shqiptare, kemi nderin që në emër të banorëve shqiptarë në Jugosllavi t’jua parashtrojmë/paraqesim juve këtë peticion, për gjendjen e kësaj pakice kombëtare dhe ta lusim Shkëlqesinë Tuaj t’ua sjellë/njofton anëtarët e Lidhjes së Kombeve”*²⁷. Aty, ndër të tjera thuhet se nuk janë emisarët e parë të popullsisë shqiptare që jetonin në Mbretërinë Jugosllave e që i drejtohen Lidhjes së Kombeve dhe mekanizmave të saj, në lidhje me gjendjen e mjerueshme të pakicës shqiptare të shkaktuara nga sundimi serb. Ky memorandum i nënshkruar nga tre priftërinj patriotë mbyllet me konstatimin se ata kishin përmendur vetëm një numër të vogël shembujsh e argumentesh *“përkrrah ekzistimit të mijëra tjerëve”*.²⁸ Megjithatë, Lidhja e Kombeve e injoroi edhe këtë peticion me plot argumentim e të dhëna reale nga vendbanimet shqiptare në Mbretërinë Jugosllave.

Pasiviteti i përsëritur i Lidhjes së Kombeve e nxiti Hasan Prishtinën që më 10 janar 1931, nga Konstanca e Rumanisë vetëm 10 muaj pas memorandumit të 15 marsit 1930 dhe 8 muaj pas Peticionit, të tre klerikëve t’i dërgonte Lidhjes së Kombeve një protestë të re që ngjan me një përmbledhje të peticionit në fjalë.²⁹ Ku thelbi i kësaj proteste ishte në fakt ai i të gjitha këtyre të dërguara më parë.

Përveç trajtimit të dhunës, terrorit, shpronësimeve dhe përgjithësisht goditjes ekonomike, kolonizimit sllav dhe shpërnguljes, mungesës së shkollave shqipe etj. Peticioni evidentonte edhe persekutimet që u bëheshin shqiptarëve katolikë për shkak të fesë, vrasjen e klerikëve të tyre dhe konfiskimin e pronave të komuniteteve fetare.³⁰ Ai gjithashtu e përsëriti kërkesën e tij *“... që shoqëria e Kombeve të emërojë një komision të paanshëm, i cili duhet të shkojë në Jugosllavi e të hetojë në vend gjendjen e minoriteteve shqiptare në Jugosllavi dhe t’i paraqet një raport shoqërisë së*

²⁷ Po aty, fl.1.

²⁸ Po aty, fl.33.

²⁹ UNLAG, F: SdN, “Minorités albanaises en Yougoslavie - Pétition du 15 janvier 1931 de Hassan Bey Prishtina”, Cote: R2166/4/25360/10528, Date(s): 1931 (Création/Production), Registry No: 4/25360/10528, Reference Code: R2166/4/25360/10528

³⁰ Po aty, fl.2; shih edhe: Marenglen Verli, “Rreth Veprimtarisë..., 361.

Kombeve”.³¹ Në këtë periudhë mjaftë dinamike e të turbullt të pas Luftës së Parë Botërore, në kuadër të sensibilizimit të kancelarive të Fuqive të Mëdha vendimmarrëse dhe të opinionit ndërkombëtar për çështjen e shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene e më vonë Jugosllave dhe çështjen shqiptare në përgjithësi, intelektualët shqiptarë të Kosovës (dhe jo vetëm), që jetonin në Mbretërinë SKS-Jugosllave e që vepronin në emigracion, kudo që ndodheshin nuk mungonin të informonin bashkëpunëtorët dhe miqtë e tyre të pranishëm në kryeqytetet e ndryshme evropiane, për situatën e shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave, si edhe t’i këshillonin si të vepronin për të prezantuar sa më mirë çështjen e pakicës shqiptare në këtë mbretëri, njëherë duke u angazhuar për realizimin e të drejtave qytetare dhe kombëtare të shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave, gjithashtu për sensibilizimin e opinionit publik botëror nëpërmjet forumeve ndërkombëtare dhe të kancelarive të Fuqive të Mëdha për çështjen e shqiptarëve të Kosovës e më gjerë.

Në vendet që jetonin e vepronin intelektualët shqiptarë, ata ishin mjaftë aktiv, si në Vjenë, Parisë, Sofje, Bukuresht, Romë, e në Turqi e Greqi, etj. Duke u përpjekur të riorganizonin mbi baza të shëndosha ndjenjën patriotike e kombëtare të shqiptarët që jetonin në Mbretërinë Jugosllave, e të krijonin komitete lokale në Kosovë dhe në qytete të ndryshme shqiptare në Maqedoni, si dhe të frenonin shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve për në Turqi e me gjerë, etj.³²

Të gjitha këto veprime ishin në kundërshtim të plot me Traktatin e Sen-Zhermenit.³³ Mirëpo, kancelaritë e Fuqive të Mëdha të Evropës kishin një mbyllje hermetike ndaj tragjedisë së Kosovës. Një intelektual shqiptar si Hasan Prishtina ishte një shqetësim për pushtetin jugosllav.³⁴ Prandaj, Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene ka arrit deri aty sa t’ua mohojë shqiptarëve

³¹ Po aty, fl. 3.

³² Më gjerësisht rreth kolonizimit, reformës agrare dhe shpërnguljes së shqiptarëve në këtë periudhë shih: Jusuf Osmani, *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1991*, Dokumente: Shpërngulja, vëllimi III, Prishtinë 2016.

³³ Për këto vendime, shih për më shumë: Izber Hoti, *Konferenca e Paqes në Paris (1919-1921) dhe çështja e viseve të pushtuara shqiptare*, Artini, Prishtinë 2012.

³⁴ Për më shumë shih: Xheladin Shala, “Hasan Prishtina - Personalitet më i denjë kombëtare”, në: Seminar ndërkombëtar për gjuhë, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 32/2, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë 2013; Xheladin Shala, *Hasan Prishtina Vështrim i shkurtër Atdhetarie*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2014.

të drejtën për të jetuar të lirë, siç edhe është paraqitura edhe nga intelektualët shqiptarë të Kosovës me dërgimin e të gjithë këtyre letrave, peticioneve e memorandumeve të lartpërmendura dhe shumë të tjera nga shqiptarët e Mbretërisë Jugosllave dhe qeveria shqiptare e asaj kohe por edhe nga intelektualët e atdhetarët tjerë që jetonin e vepronin jashtë dhe brenda shtetit shqiptar.

Kastriot VESELAJ

SUMMARY

OF ALBANIAN INTELLECTUALS TO THE LEAGUE OF NATIONS: ADVOCATING FOR CIVIL AND NATIONAL RIGHTS OF ALBANIANS IN THE KINGDOM OF SERBS, CROATS, AND SLOVENES (1924-1931)

We will rightly state that these requests, letters, petitions and memoranda, continuously sent to the League of Nations and its mechanisms, since its creation, until the end of the Second World War, and drafted by the intellectuals of the time such as Hasan Prishtina, Bajrami Curri, Bedri Pejani, Dom Gjon Bisaku, Dom Shtjefën Kurti, Dom Luigj Gash and others, are the most important documents in the history of Albanian national diplomacy, which rightly testify to the continuous efforts of these intellectuals for internationalization of the “The Albanian national issue”, especially of the Albanians in the Kingdom of SKS-Yugoslav, that is where the emphasis of this paper is.

These intellectuals have reacted many times, from 1924 to 1931, against the difficult situation of high taxes, numerous punishments, the ban on education in the mother tongue, oppression, terror, migration, colonization, agrarian reforms, etc. Because with the re-occupation of Kosovo and other Albanian lands by the Kingdom of Serbo-Croatian-Slovenian, the Albanian people with all the great natural resources and the vitality of the population that it had, in the lands inhabited by Albanians reigned a difficult economic and cultural period, where unlike the other peoples of this Kingdom, the Albanians were denied almost every national right, democratic but also humane.